

OPINION

MBI

“TRANSPARENCËN E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË SUBJEKTEVE TREGTARE ABUZUESE NGA ANA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE”

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është njohur kohët e fundit me çështjen e identifikimit të kompanive tregtare të karburanteve të cilat janë konstatuar me shkelje nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, dhe për këtë bën kujdes të shprehë qëndrimin e tij mbi gjetjen e ekuilibrit të duhur nga institucionet publike ndërmjet të drejtës për informim të publikut dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Siç dihet, Komisioneri është i vetmi autoritet përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe për këtë vazhdimisht rekomandon apo sugjeron përmes opinioneve e publikimeve kryerjen e veprimtarisë së kontrolluesve të të dhënave personale në përputhje me ligjin.

Autoriteti në fokus të punës së tij ka mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe ka rol monitorues e kontrollues në zbatimin e detyrimeve ligjore nga kontrolluesit publikë e privatë që përpunojnë të dhëna personale.

Duke marrë shkas nga rasti në fjalë, si edhe në raste të tjera analoge, ku në veçanti në administratën publike, koncepti i privatësisë mund të keqpërdoret në mënyrë instrumentale për t’iu shmangur transparencës.

Për të ofruar një panoramë të përgjithshme mbi trajtimin e rasteve të tilla, Komisioneri publikon këtë opinion me qëllimin për të ndërgjegjësuar të gjithë autoritetet publike, kompanitë private dhe subjektet e ligjit në lidhje me “transparencën e publikimit të të dhënave të subjekteve tregtare abuzuese nga ana e institucioneve publike”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 23 të saj, garanton të drejtën e informimit duke theksuar se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Pra, e drejta e informimit të publikut është një e drejtë kushtetuese ashtu siç është dhe e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale të individit (neni 35). Të dy këto të drejta, si të drejta kushtetuese janë në zbatim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe zbatimi i tyre në rastet konkrete kërkon balancimin e drejtë të tyre duke parë si prioritare gjithmonë mbrojtjen e interesave të personit.

Për sa përket të shumë përmendurit Ligjit nr 10 433, datë 16.06.2011 “*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*” në nenin 9 dhe shprehimisht në paragrafin e parë është parashikuar se:

1. *“Inspektorati informon publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrativ të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë e juridikë.”*

Në opinionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **Inspektorati ka si detyrim ligjor parësor të informojë publikun mbi konstatimet që janë bërë gjatë procedimit administrativ.** Publikimi si proces, konsiderohet si publikim në interes të publikut thënë ndryshe të konsumatorit, pasi janë këta të fundit të cilët preken drejtpërdrejtë, shpenzojnë për shërbimin që marrin dhe që sigurisht kërkojnë cilësinë e duhur në përputhje me shpenzimin. Pra, në këtë rast prevalon interesi i konsumatorit.

Ndërsa në paragrafin e dytë parashikohet se:

2. *“Informimi, sipas parimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë dhe brenda kufijve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit apo personave të tjerë.”*

Edhe në këtë dispozitë parashikohet detyrimi për informim dhe keq interpretimi i saj nga ana e institucioneve publike se publikimi i vetëm emrit të kompanisë konsiderohet si shkelje e privatësisë rëndon problematikën. Edhe nëse do të ndodhemi në rastin kur ky publikim do të shoqërohet me të dhëna të tjera personale të cilat do të tejkalojnë qëllimin e publikimit të bazuar në ligjin e tyre organik atëherë do të duhet të bëhet përsëri balancimi i këtyre dy të drejtave të mësipërme, duke anuar peshorja nga interesi i publikut.

Pra nuk është e udhës të bëhen interpretime të gabuara e për rrjedhojë të mos sigurohet transparenca e duhur ndaj publikut i cili kërkon të mirë informohet për cilësinë e shërbimeve që i jepen.

Edhe nëse i referohemi pikës 3 të nenit 31 të ligjit nr. 10 433, datë 16.06.2011 *“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, në të cilën është parashikuar ruajtja e konfidencialitetit *“nga ana e inspektorëve gjatë procedimit administrativ të inspektimit si dhe detyrimi i punonjësve të tjerë përveç inspektorëve të cilët marrin pjesë në procedurat inspektuese, të mos përhapin a përdorin të dhënat personale dhe ato që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit a të personave të tjerë të përfshirë”*, sërish do të duhet të bëhet dallimi midis asaj që është në të mirë të publikut (konsumatorit), detyrimit ligjor për ta informuar dhe asaj që nuk duhet bërë e ditur pasi prek sferën intime të personit apo nxjerrjen e sekretit profesional.

Në këndvështrimin e Komisionerit parashikimi i ruajtjes së sekretit profesional gjatë veprimtarisë inspektuese i shërben mos dëmtimit të aktivitetit tregtar nga konkurrenca e pandershme, ndërsa, publikimi i emrit të subjektit tregtar i cili abuzon në dëm të konsumatorit nuk ka lidhje me ruajtjen e sekretit profesional. Publikimi i abuzuesit është një detyrim ligjor i institucioneve publike i cili parashikohet në ligjet e tyre organike siç është rasti i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ku në Ligjin nr. 9875 date 14.02.2008 *“Për Metrologjinë”* i ndryshuar me Ligjin nr. 10217 datë 21.01.2010 në nenin 2 shprehimisht thuhet:

“Ky ligj ka si qëllim të realizojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve”.

Edhe për sa i përket rolit të organit të prokurorisë në këtë rast por edhe në raste të ngjashme, si autoriteti zyrtar i përcaktuar me ligj për të vepruar për qëllime të parandalimit dhe ndjekjes së kryerjes së veprave penale, ka qasje në dosjet e çdo institucioni publik apo kompani private gjithmonë duke zbatuar parimet e konfidencialitetit, të parashikuar edhe në aktet normative përkatëse.

Duke u fokusuar në këtë rast dhe jo vetëm, tashmë që kanë nisur hetimet për rastin në fjalë parashikimi ligjor i përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilin shprehimisht thuhet se:

“Përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, për kryerjen e një vepre penale kundër rendit publik dhe të veprave të tjera në fushën e të drejtës penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kryhet nga autoritetet zyrtare të përcaktuara në ligj”, është tërësisht i zbatueshëm.

Në përfundim:

Ajo se çfarë përbën shkelje të privatësisë, nuk mund të konsiderohet publikimi i emrave të kompanive të cilat në kuptim të ligjit tonë janë kontrollues të të dhënave personale pasi mbledhin, ruajnë, përhapin apo i transferojnë këto të dhëna pra përpunojnë të dhëna personale (ndër të tjera kanë detyrimin ligjor të njoftojnë pranë Komisionerit në drejtorinë e Regjistrimit ashtu si dhe vetë Drejtoria e Metrologjisë ka vepruar).

Transparenca për çfarë lejon pika 1 e nenit 9 e Ligjit “Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, për të mbrojtur interesat e subjekteve të të dhënave në këtë rast të konsumatorëve, duhet konsideruar e rëndësishme, dhe e pakursyer, jo e trajtuar si e pamundur, në kundërshtim me ligjin, apo të krijohet dilema se çfarë është interes i rëndësishëm publik dhe se çfarë prevalon.

Ky në fakt, është veprimi më i mirë ligjor për të qenë në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Opinioni i vjen në ndihmë dhe duhet marrë në konsideratë nga të gjithë kontrolluesit publikë e privatë të cilët nevojitet të zbatojnë në mënyrë të drejtë e të ligjshme legjislacionin e tyre përkatës në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)